

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

NR.-56- akti

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbëre nga:

GJYQTAR - ARTAN GJERMËNI,

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Denada Runaj**, sot më datë **12/02/2014** me prezencën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurore **Suela Salavaçi** dhe te shtetasit si i trete **A.D** mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale me nr. **56** Akti, që i përket:

KERKUES: Shoqëria “D-P-Z” Gashi Towing Servic ‘, shoqëri , person juridik me adrese , rruga “Besnik Laiqi” 3000 Peje, Kosove, përfaqësuar nga z.Dritan Jahaj me nr. 3561 license, Dhoma e Avokatisë Tirane me autorizimin e dates 23/09/2013.

OBJEKTI: Kundërshtim i vendimit te sekuestrimit date 05/05/2012 i Komisarariatit te Policisë nr.2, Tirane te automjetit tip BMW X6 X drive 4od sports A me targa te rregjistruar (.....)

BAZA LIGJORE : Neni 212, 218 i Kodit te Pr.Penale .

Ne konkluzionet përfundimtare :

- **Avokati** kërkoi : Pranimin e kerkeses.

-**Prokurorja** **Suela Salavaçi**, ne cmim te gjykates.

Personi i trete : A.D: Rezimin e kerkeses

Gjykata pasi dëgjoji konkluzionet përfundimtare, deklaroi te mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe si cmoi provat ne tërësi

VEREN:

Prane kësaj gjykate eshte paraqitur per gjykim kërkesa penale e kërkuetit Shoqëria "D-P-Z" Gashi Towing Servis, me objekt 'Kundërshtim i vendimit te sekuestrimit date 05/05/2012 i Komisarariatit te Policisë nr.2, Tirane te automjetit tip BMW X6 X drive 4od sports A me targa te rregjistruar (.....)

Ankuesi ka paraqitur ankim e parashtron(sintetike) se:

Shoqëria D-P-Z "Gashi Towing Servis" eshte person juridik dhe ushtron aktivitetin e saj në fushën tregëtimit të automjeteve. Shoqëria "BMW Financial Services" autorizon më datë 30.07.2013 shoqërinë "Deva" që të marr përsipër të gjitha interesat ligjore në lidhje me automjetin BMW X6 xDrive40d SportsA gjithashtu i jep tagrin për të dhënë autorizim personave të tretë. Shoqëria D-P-Z "Gashi Towing Servis" autorizohet prej shoqërisë "Deva" që të ushtrojë të gjithat interesat ligjore për sigurimin, lirimimin dhe kthimin e automjetit BMW X6 xDrive40d SportsA. Në datë 22.09.2011 BMW Bank GmbH ka lidhur kontrata për lizing me nr.Dosje SF1-243 me objekt shitjen e automjetit tip BMW X6 xDrive40d SportsA me targa të regjistruara (.....) Marrësi i Lizingut është **B1 Gastro udn Handel GmbH** dhe garantues **Christoph Remmler Baumschule**. Marrësi i lizingut ka marrë nga firma BMW Bank GmbH në bazë të kontratës së lizingut, automjetin tip BMW X6 xDrive40d SportsA me targa të regjistruara (.....) me numër shasie(.....) me një afat prej 36 muajsh me lizing. Më datë 29.02.2012 BMW Financial Service i është drejtuar me shkresë marrësit të lizingut **B1 Gastro udn Handel GmbH** ku i vihet në komunikim **Ndërprerja e Menjëhershme e Kontratës së Lizingut** pasi deri në atë moment, **B1 Gastro udn Handel GmbH** nuk ka paguar detyrimet financiare të parashikuara në kontratën e lizingut. Shoqëria BMW Bank GmbH më datë 22.05.2012 lëshon **Urdhër Për Sigurimin e Automjetit tip BMW X6 xDrive40d SportsA me targa të regjistruara (.....)** Më datë 05.05.2012 vendoset për sekuestrimin e automjetit tip BMW X6 xDrive40d SportsA me targa të regjistruara (.....)

Ankuesi pretendoi ne menyre sitetike se :

Së pari, Automjeti tip BMW X6 xDrive40d SportsA me targa të regjistruara (.....) që prej datës 22.05.2012 duhej të kthehej pranë BMW Bank GmbH pasi marrësi i kontratës së

lizing me Nr. inventari 905127 kishte thyer detyrimet që i përksinin sipas kontratës së lizing dhe BMW Bank Gmb kishte nxjerr një Urdhër për Sigurimin e Automjetit.

Së dyti, Pala e trete z. A.D ishte koshent që ky automjet nuk ishte në pronësi të tij dhe se ai ishte mashtruar nga persona të tjerë.

Së treti, Automjeti i blerë në formën lizing derin ne momentin e likuidimit total të kredise është në pronësi të BMW Bank Gmb dhe nuk mund të shkojë pronësia te asnjë personë tjetër. Kjo vërtetohet dhe nga librezat origjinale të makinës e cila disponohet deri në likuidimin total të shumës së kontratës së lizing-ut nga BMW Bank Gmb.

Për sa parashtruar më sipër kërkojmë që ti kthehet automjeti tip BMW X6 xDrive40d SportsA me targa të regjistruara (.....) shoqërisë **BMW Bank GmbH** si titullar absolut dhe i vetëm i pronësis mbi këtë automjet.

Nga ana e Organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tirane u pretendua se :

Ne date 25/05/2012 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane ka rregjistruar procedimin penal me Nr.2544 , për veprën penale të “Mashtrimit “, të parashikuar nga neni 143 i K.Penal , pasi ka rezultuar se në date 05/05/2012 në komisariatit të Policisë nr. 2 Tirane është paraqitur shtetasi B.B i cili ka kalëzuar se para disa muajsh ka blerë një makinë BMW X6 ngjyre të bardhë me targa (.....) Ai këtë mjet ja kishte dhënë shokut të tij M.A për të shkuar deri në Kosovë për të takuar një zotëri të tij. Pasi kanë kaluar dy javë B. e ka telefonuar M. për të kërkuar makinën por ai i ka thënë se duhet të shkonte deri në Lezhë dhe do tja kthente makinën. Pasi kaluan dhe disa kohe M. i kishte thënë kallëzuesit se makina ishte prishur dhe po kërkonte disa pjesë për ta rregulluar. Duke e kuptuar që M. po e mashtronte , B. ka ardhur në Shqipëri për të gjetur mjetin dhe e ka parë atë të parkuar para ‘Casa Italia’. Ai i ka telefonuar M. , por ai i ka thënë që nuk është e vërtetë. Kallëzuesi në date 04/05/2012 e ka parë të parkuar makinën në rrugën ‘Ismail Qemali ’ dhe ajo mbante targa (.....). Pasi ka njoftuar policinë mjeti është parkuar në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.2. Tirane. Nga verifikimet e bëra ka rezultuar se këtë mjet e përdorte shtetasi A.D, i cili ka shpjeguar se këtë makinë ja kishte shitur një i njohuri i tij.M.A në Dhjetor të vitit 2011 duke i dhënë një kapar prej 15 mijë Euro. M. i ka thënë që makina ishte e një shoku të tij dhe se do të shkonte në Gjermani për të bërë kontratë dhe për të sjellë edhe kopjen tjetër të censit, ndërsa ai do të jepte dhe 25 Mijë Euro të tjera . Sipas

kallëzuesit makina është blerë në Gjermani neperjet bankes me kredi prej 75 mijë Euro.

Lidhur me ngjarjen shtetasi M.A ka deklaruar se ka qene ai që ka dijeni për shitjen e makines dhe kaqene ai që e ka dhënë aprovimin për shitjen e saj. Për të sqaruar rrethanat nga ana e organit të akuzes është drejtuar një leterprorosi autoriteteve Gjermani dhe me procesverbalin e datë 05/05/2012 është sekuestruar në cilësinë e provës materiale autovetura BMW X6 , ngjyre e bardhe me targa (.....). Për shkak se interesat e hetimit nuk demtohen duke ia lenë në ruajtje për mostjetësim etj sipas nenit 214/1/2 të K.Pr.Penale është vendosur nga organi i akuzes lenia në ruajtje e automjetit BMW X6 , ngjyre e bardhe me targa (.....) shtetasit A.D i thurrur si trete në këtë gjykim

Mbi bazën e materialit kallëzues nga ana e organit të akuzes është regjistruar procedimi penal me të pandehur shtetasit M.A etj dhe çështja është sjelle për gjykim në këtë gjykatë.

Ne seancën gjyqësore të datës 12/02/2014 nga ana e shtetasit A.D është pretenduar se: Makina BMW X6 , ngjyre e bardhe me targa (.....) i është vjedhur në qytetin e Lacit dhe të nesërmen në datë 12/02/2014 ky shtetas ka bërë kallëzimin e tij pranë Komisarariatit të Policisë Kurbin.

Për sa më sipër në analizë të provave që ndodhën në këtë fashikull gjyqësor , nga ana e përfaqësuesit i ankuesit u kërkua pranimit i ankimit, nga ana e prokurores u la në cmim të gjykatës dhe nga ana e shtetasit A.D u kërkua rrezimi i kërkesës pasi kësaj kërkesë i mungon objekti i saj, pasi makina është vjedhur.

Gjykata pasi çmoi në tërësi provat, në analizë të pretendimeve të paraqitura sipas ankimit respektiv dhe në raport me dispozitat procedurale penale që lidhen me kontrollin gjyqësor, mbi veprimtarinë e prokurorit konkludon në mos pranimin e ankimit si të pa bazuar në ligj.

Sipas nenit 301 të K.Pr.Penale, sanksionohet se :

Vleftësimi i sekuestros

1. Kur vë sekuestron, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal shkakun dhe i dorëzon një kopje të aktit personit, të cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonësë dhe sidoqoftë jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja.

2. Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankimi në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe mbrojtësi I tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t'i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestros.

Neni 214

Ruajtja e sendeve të sekuestruara

1. Sendet e sekuestruara ruhen në sekretari. Kur kjo nuk është e mundur ose e përshtatshme, organi procedues urdhëron që ato të ruhen në një vend tjetër, duke përcaktuar mënyrën e ruajtjes.
2. Gjatë veprimtimit të dorëzimit, ruajtësi paralajmërohet për detyrimin e ruajtjes dhe të paraqitjes së sendeve kur kërkohen nga organi procedues, si dhe për dënimin e parashikuar nga ligji penal për atë që shkel detyrimin e ruajtjes.

Neni 218

Rregullat për kthimin e sendeve të sekuestruara

1. Gjykata vendos kthimin e sendeve të sekuestruara kur nuk ka dyshim për përkatësinë e tyre.
2. Kur sendet janë sekuestruar pranë një të treti, kthimi nuk mund të urdhërohet në dobi të të tjerëve, pa u dëgjuar i treti nga gjykata.
3. Gjatë hetimeve paraprake, kthimi i sendeve të sekuestruara urdhërohet nga prokurori. Kundër këtij urdhri të interesuarit mund të bëjnë ankimi në gjykatë.

Sa me sipër ne interpretojmë te këtyre dispozitave organi i prokurorisë para se të linte në ruajtje autoveturën duhet të kishte konsumuar të gjitha mjetet ligjore për perkatesinë e pastaj të liqeshin të tretit, veprime të cilat nuk i ka bërë, e për këtë shkak vendimi për lenien në ruajtje duhet të cfuqizohet. Pretendimi i kërkuesit që gjykata tja lej atij në ruajtje sendin e sekuestruar si prove e automjetit tip BMW X6 x Drive 4 OD Sports A me targa të rregjistruara (.....) shoqërisë BMW Bank GMBH si titullar absolut dhe i vetëm i pronës, nuk mirëpritet, me argumentin jo se atij nuk i takon ta mbaje në ruajtje këto sende të sekuestruar si prove, por nuk është në tagrin e gjykates ky veprim proceduraj pasi do të ndodheshim para faktit që gjykata ben aktin që si takon, por është organi akuzës që pasi dhenies të këtij vendimi të procedoj. Pretendimi i të tretit se kërkesa duhet të rrezohet pasi sendi është vjedhur

nuk mirepritet pasi eshte ne tagrin e prokurorit ne momentin e vendimarrjes se tij te verifikoj kete fakte, e me pas te vendoset.

PER KETO ARESYE

Gjykata bazuar ne neneve 212,214,218 301 K.Pr.Penale gjykata

VENDOSI:

-Pranimin pjesërisht te kërkesës.

-Shfuqizimin e vendimit te sekuestrimit date 05/05/2012 i Komisarariatit te Policise Nr. 2 Tirane, te automjetit tip BMW X6 X Drive 4 dod Sports A e targa te rregjistruara (.....), ne lidhje me aktin e lenies ne ruajtje shtetasit A.D me date 12/07/2012.

-Rrezimin per pjesen tjeter te objektit .

-Shpenzimet procedurale i ngarkohen organit të prokurorisë.

-Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 10 ditëve.

-U shpall sot ne Tirane me date 12/02/2014.

SEKRETARE

Denada Runaj

G J Y Q T A R

Artan Gjermëni